REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA

www.komuna-kline.org

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVO - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA
Nr.No.Br. 357-132801/2
Data-Date-Datum 19.07.2021
Klinë-Klina

**Bazuar ne LPP 04/L-042 I ndryshuar dhe amandaetuar ne Ligjin nr.05/L-068 dhe 05/L-092 , neni 108/A , zya e prokurimit ,me date 19.07.2021, ,ne përgjigje te Kerkeses per Rishqyrtim te O.E BERISHA CONSTRUCTION SHPK NGA KLINA te postuar me date 16.07.2021 merr :**

# VENDIM

**<u>1. HUDHET E PABAZUAR Kërkesa</u> e O.E "BERISHA CONSTRUCTION SHPK " NGA KLINA NE KERKESES PER RI SHQYRTIM KUNDER VENDIMT PER ANULIM TE PROCEDURES TE DATES 12.07..2021 te Procedurës e Prokurimit Nr. 634-21-4030-521 –NR INTERN 634-21-37-521"NDERTIMI I SERAVE PER PERFITUESIT INDIVIDUAL -RITENDER "**

**<u>2. MBETET NE FUQI Vendimi i A.K për per ANULIM te tenderit i dates 12.07.2021.</u>**

# Arsyeshmeri

**Pretendimet e Ankuesit O.E "BERISHA CONSTRUCTION SHPK " nga Klina , nuk qendrojne ne asnjë nga pretendimet e tija.**

**LPP – Aktual kërkon qe Deklarata nen Betim duhet te jete eplotesuar dhe neneshkruar nga Pergjegjesi i O.E.**
**SHIKO KOMENTIN :**

***72. 19.02.2020. A duhet kërkuar sqarime shtesë në bazë të nenit 72 të LPP-ës, në rast se Operatorët Ekonomik nuk e dorëzojnë bashkë me ofertat e tyre "Deklaratën nën betim" ?***

Konform nenit 87, paragrafit 2, nën-paragrafit 2.8 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në pyetjen e parashtruar nga palët e i interesit, KRPP sqaron si në vijim:

Për dokumentacion dhe ofrimin e sqarimeve shtesë flet neni 59 dhe neni 72 i LPP-së.

Në përputhje me paragrafët 1 dhe 2 të nenit 72 të këtij ligji, AK-të mund të kërkojnë nga OE-të që të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë ndonjë dëshmi të specifikuar në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji.

Ndërsa paragrafi 3 i nenit 72 të këtij ligji përcakton si në vijim:

*Sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet* ***vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.***

**"Deklarata nën betim" është kusht administrativ dhe dëshmi që kërkohet sipas nenit 65 të LPP-së për të dëshmuar përshtatshmërinë e OE-së për pjesëmarrje në aktivitetin aktual** të prokurimit (pra që është në fazën e tenderimit) dhe si e tillë ajo nuk mund të kërkohet në bazë të nenit 72 të LPP-ës, ngase ekzistenca e saj (pra e deklaratës nën betim) nuk mund të verifikohet në mënyrë objektive nga AK siç e kërkon paragrafi 3 i nenit 72 të LPP-ës.

Pra me një fjalë, deklarata nën betim **nuk** është një dokument i cili e plotëson kërkesën e paragrafit 3 të nenit 72 të LPP-ës, për këtë arsye, **Deklarata nën betim, duhet të nënshkruhet vuloset dhe** duhet të dorëzohet së bashku me tender para afatit të fundit për dorëzimin e tenderëve të specifikuar në Dosjen e Tenderit.

**Shikuar nga kjo Nuk vlene neni 72 i LPP per dokumente shteseapo sqarim i tenderit .**

**Ju ne Kerkesn tuaj keni dhene disa faqe te Autorizimit , por edhepse eshte emanget nuk ka data kur eshte përpiluar as Vertetimet e Paleleve dhe te Vertetuar nga Noteri .**
**Perkunder kësaj Cdo dokument qe ka baze ndryshimet dhe autorizimet duhet te jete i bashkangjitur edhe Autorizimi .**

***Baza juridike***

***Kunder këtij vendimi O.E , bazuar ne Nenin 109 te LPP ka te drejte te paraqes ankes pranë OSHP .***

*I dergohet :*

*1.Ankuesit O.E 'BERISHA CONSTRUCTION SHPK –Kline*

*2.ZKA*

*3.Njesise Kerkuese*

**Abaz Foniqi**

[Nënshkrimi]